



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË DENTARE

Nr. 482 / Prot.
16

Tiranë, më 04/09/2026

Lënda: Publikohen vendet vakante për personelin akademik me kohë të pjesshme për Lëndët e Specialitetit të Stomatologjisë të propozuara nga Departamentet, vendet vakante për Lëndët Formuese dhe Mjekësore në Programet e Studimit “Master i Shkencave në Stomatologji”, Bachelor në “Higjenist Dentar” dhe “Teknikë Dentare”, të Fakultetit të Mjekësisë Dentare, UMT.

Në vijim të Urdhrit Nr. 86, datë 03.09.2026 të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë Tiranë “Për miratimin e kriterëve dhe dokumenteve për personel akademik me kohë të pjesshme, të Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Rektorit nr.2, datë 10.07.2026 “Për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2026-2027, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Udhëzimit Nr. 8, datë 13.11.2025, “Për punësimin e personelit akademik të ftuar në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Udhëzimit Nr. 6, datë 18.09.2025 “Për punësimin e personelit akademik ndërmjet njërive kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe nga Institucione të tjera të arsimit të lartë”, Udhëzimit 29, datë 10.09.2018 të Ministrisë së Arsimit, shpallen vendet vakante për personelin akademik me kohë të pjesshme për Lëndët e Specialitetit të Stomatologjisë të propozuara nga Departamentet, vendet vakante për Lëndët Formuese dhe Lëndët Mjekësore në Programet e Studimit “Master i Shkencave në Stomatologji”, Bachelor në “Higjenist Dentar” dhe “Teknikë Dentare”, të Fakultetit të Mjekësisë Dentare, UMT, së bashku me kriteret e përgjithshme, specifike dhe dokumentacionin e kërkuar për aplikim.

➤ *Kritere të përgjithshme për Departamentet e FMD dhe Lëndët Formuese dhe Mjekësore në Programet e Studimit “Master i Shkencave në Stomatologji, Bachelor në “Higjenist Dentar” dhe “Teknikë Dentare”:*

1. Të ketë përfunduar studimet në një program të integruar ose master shkencor dhe të jetë diplomuar në fushën përkatëse, në universitetet brenda ose jashtë vendit;
2. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkuron;
3. Të zotërojnë me dëshmi një nga pesë gjuhët e huaja të BE (Anglisht, Gjermanisht, Frëngjisht, Italisht, Spanjisht);
4. Të jetë shtetas shqiptar;
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje;
6. Të zotërojnë gjuhë shqipe, të shkruar dhe të folur;
7. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
8. Të jetë në kushte shëndetësore që lejon kryerjen e detyrës përkatëse;
9. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna nga institucione të edukimit;
10. Të mos ketë mbushur moshën e pësonit të pleqërisë, referuar Ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, si dhe Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar;
11. Të zotërojnë kualifikim të ciklit pasardhës nga programi i studimit që aplikon për të dhënë mësim, (pika 6, neni 59 i Ligjit Nr.80/2015).

Dokumentacioni i kërkuar për aplikim (i inventarizuar):

1. Kërkesë me shkrim për shprehje interesi, drejtuar njësisë bazë ku do të konkurrojë, ku të përcaktohet lënda/moduli përkatës dhe programi i studimit ku kërkohet angazhimi në mësimdhënie.
2. Jetëshkrim (Curriculum Vitae), sipas formatit standard (Europass), i përditësuar, ku të jetë e detajuar veprimtaria shkencore e kandidatit.
3. Fotokopje e pasaportës ose kartës së identitetit.
4. Leje nga punëdhënësi në institucionin/subjektin etj., ku punon (nëse është i punësuar).
- 4.a. Nëse kandidati fitues është i punësuar në institucione të tjera, leja e punëdhënësit duhet të dorëzohet nga vetë individi/kandidati.
- 4.b. Në rastin kur kandidati fitues është personel akademik me kohë të plotë në një IAL tjetër, UMT i drejtohet IAL-së përkatëse për konfirmimin e lejes së mësimdhënies.
5. Kopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të të gjitha programeve të studimit:
 - Program i Ciklit të Parë të Studimeve;
 - Program i Ciklit të Dytë të Studimeve;
 - Program i Ciklit të Tretë të Studimeve (Master Ekzekutiv/Specializim Afatgjatë në fushën e Mjekësisë/Doktoraturë).

Kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë vendit duhet të depozitojnë fotokopjen e noterizuar të vërtetimit të njohjes së dokumentacionit të kërkuar më sipër nga Ministria përgjegjëse për Arsimin.

- 5.a. Dëshmi (fotokopje të noterizuara) të titujve Profesor/Profesor i Asociuar. Për dëshmitë e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e certifikatës së njohjes nga organi kompetent (MA).
6. Kopje e noterizuar e dëshmisë së gjuhës së huaj.
7. Kopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) dhe/ose vërtetim nga E-Albania për pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore.
8. Dëshmi penaliteti (lëshuar brenda 3 muajve të fundit nga data e aplikimit).
9. Vërtetim i aftësisë për punë (i vlefshëm për tre muajt e fundit nga data e aplikimit për vendin e punës).
10. Kandidatët që aplikojnë në lëndët klinike dorëzojnë kopje të noterizuar të licencës për ushtrimin individual të profesionit, lëshuar nga Urdhri përkatës (Mjek, Infermier, Stomatolog).
11. Formular Vetëdeklarimi sipas formës së kërkuar nga Ligji nr. 138/2015.
12. 2 (dy) referenca nga personeli akademik i kategorisë Profesor, nëse kandidati aplikon për here të parë. Përfshihen nga ky detyrim kandidatët që gëzojnë titull akademik.
13. Çdo dokument tjetër që provon punësimin si personel akademik me kohë të plotë ose të pjesshme, trajnimet, arsimin shtesë, artikujt, tekstet, revistat, projektet shkencore, vlerësimet pozitive apo të tjera të kërkuara nga kriteret specifike dhe/ose preferenciale, apo të përmendura në jetëshkrim.

Shënim:

- Aplikantët duhet të kenë së paku kualifikimin e ciklit pasardhës për programin e studimit ku aplikojnë.
- Dosja duhet të jetë e pajisur me fletë inventari, ku të pasqyrohet i gjithë dokumentacioni përbërës dhe numri i faqeve që përmban çdo dokument.

I. Departamenti i Terapisë Stomatologjike propozon: 6 vende në Msc Stomatologji
4 vende në Bachelor “Higjenist Dentar”
“Teknikë Dentare”

➤ Kritere specifike që duhet të plotësojë kandidati për vendet vakant në Departamentin e Terapisë në programin e studimit Msc Stomatologji janë:

1. Të ketë mbaruar studimet universitare për stomatologji me note mesatare mbi 8;
2. Të ketë cikël të tretë studimi, Doktoraturë ose të ketë përfunduar Specializim Afatgjatë në fushën përkatëse;
3. Të ketë mbi 5 (pesë) vjet eksperiencë pune klinike;
4. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse;
5. Të ketë license profesionale të ushtrimit të profesionit;
6. Të ketë publikime në revista shkencore, pjesëmarrje aktive në veprimtari kërkimore shkencore ose aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit;

➤ Kritere specifike që duhet të plotësojë kandidati për vendet vakante në Departamentin e Terapisë në programin e studimit Bachelor në “Higjenist Dentarë” dhe “Teknikë Dentare” janë:

1. Të ketë mbaruar studimet universitare për stomatologji me notë mesatare mbi 8;
2. Të ketë cikël të dytë ose të tretë studimi, Doktoraturë ose të ketë përfunduar Specializimeve Afatgjata në fushën përkatëse;
3. Të ketë mbi 5 (pesë) vjet eksperiencë pune klinike;
4. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse;
5. Të ketë license profesionale të ushtrimit të profesionit;
6. Të ketë publikime në revista shkencore, pjesëmarrje aktive në veprimtari kërkimore shkencore ose aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit;

II. Departamenti i Ortopedisë Stomatologjike propozon: 7 vende Msc Stomatologji
11 vende Bachelor “Higjenist Dentar”
“Teknikë Dentare”

➤ Kritere specifike që duhet të plotësojë kandidati për vendet vakante në Departamentin e Ortopedisë në programin e studimit Msc Stomatologji janë:

1. Të ketë mbaruar studimet universitare për stomatologji me notë mesatare mbi 8;
2. Të ketë cikël të tretë studimi, Doktoraturë ose të ketë përfunduar Specializim Afatgjatë në fushën përkatëse;
3. Të ketë mbi 3 (tri) vjet eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse të Protetikës Fikse ose të Lëvizshme;
4. Të ketë mbi 3 (tri) vjet eksperiencë pune klinike;
5. Të ketë licensë profesionale të ushtrimit të profesionit;

➤ Kritere specifike që duhet të plotësojë kandidati për vendet vakante në Departamentin e Ortopedisë në programin e studimit Bachelor në “Higjenist Dentarë” dhe “Teknikë Dentare” janë:

1. Të ketë mbaruar studimet universitare për stomatologji me notë mesatare mbi 8 (tetë);

2. Të ketë cikël të dytë ose të tretë studimi, Doktoraturë ose të ketë përfunduar Specializimeve Afatgjata në fushën përkatëse;
3. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse;

III. Departamenti i Kirurgjisë OMF&Paraklinike propozon: 4 vende Msc Stomatologji, Bachelor “Higjenist Dentar”, “Teknikë Dentare”

➤ Kritere specifike që duhet të plotësojë kandidati për vendet vakante në Departamentin e Kirurgjisë OMF&Paraklinike janë:

1. Të ketë mbaruar studimet universitare për stomatologji ose mjekësi me notë mesatare mbi 8 (tetë);
2. Të ketë cikël të tretë studimi, Doktoraturë ose të ketë përfunduar Specializim Afatgjatë në fushën përkatëse;
3. Të ketë mbi 5 (pesë) vjet eksperiencë pune klinike në Klinikën Stomatologjike ose në Qendrën Universitare “Nënë Tereza”;
4. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse;
5. Të ketë licensë profesionale të ushtrimit të profesionit;
6. Të ketë publikime në revista shkencore, pjesëmarrje aktive në veprimtari kërkimore shkencore ose aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit;

IV. Lëndët Formuese në Programet e Studimit “Master i Shkencave në Stomatologji”, Bachelor në “Higjenist Dentar” dhe “Teknikë Dentare” vendet si më poshtë:

1. Fizikë	2
2. Kimi Inorganike	3
3. Kimi Organike	2
4. Biologji e Përgjithshme	2
5. Informatikë e Aplikuar për Shkencat Mjekësore	2
6. Gjuhë Latine	1
7. Gjuhë e Huaja (Anglisht)	2
8. Sociologji	1
9. Edukim Fizik	1

➤ Kriteret specifike për Lëndët Formuese

- Të ketë gradën Doktor dhe/ose Titull Shkencor;
- Të ketë eksperiencë pune në fushën përkatëse;
- Të ketë eksperiencë mësimdhënie në fushën përkatëse.

V. Lëndët Mjekësore në Programet e Studimit “Master i Shkencave në Stomatologji”, Bachelor në “Higjenist Dentar” dhe “Teknikë Dentare” vendet si më poshtë:

1. Psikologji mjekësore	1
2. Radiologji Orale&Maxilofaciale	3
3. Imunologji-Alergologji	1

4. Histologji	1
5. Anatomi Normale	2
6. Mikrobiologji	2
7. ORL	2
8. Okulistikë	2
9. Sëmundje të Brendshme	2
10. Fiziologji Patologjike	3
11. Biokimi	2
12. Fiziologji Normale	2
13. Dermatologji	2
14. Sëmundje Infektive	3
15. Farmakologji	3
16. Sëmundje Kirurgjikale	1
17. Ekonomi Shendeti	1
18. Anatomi Patologjike	1
19. Pediatri	1
20. Gjenetikë Mjekësore	2
21. Neurologji	2

➤ Kriteret specifike për Lëndët Mjekësore

- Të ketë Doktoraturë ose të ketë Specializim Afatgjatë në fushën përkatëse;
- Të ketë eksperiencë pune në specialitetin përkatës;
- Të ketë eksperiencë në mësimdhënie;
- Të ketë publikime në revista shkencore, pjesëmarrje aktive në veprimtari kërkimore shkencore ose aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit.

Aplikimet do të dorëzohen pranë zyrës së Protokollit në Fakultetin e Mjekësisë Dentare, UMT, duke filluar nga data 08.09.2026 – 14.09.2026 (7 shtatë ditë kalendarike, përfshirë edhe ditën e Shtunë dhe të Dielë përgjatë orarit zyrtar). Kriteret dhe dokumentacioni për personelin akademik me kohë të pjesshme janë të publikuara në faqen zyrtare të FMD- <https://www.fmd.edu.al> dhe të UMT-së <http://www.umed.edu.al>.

DEKAN

SILVANA BARA

